

331.5-053.2(497.115)

Donjeta Morina, MSc¹

**SHKAQET DHE PASOJAT E PËRFSHIRJËS SË FËMIJËVE NË
TREGUN E PUNËS - RASTI I KOSOVËS**

**ПРИЧИНИТЕ И ПОСЛЕДИЦИТЕ НА ВКЛУЧУВАЊЕТО НА
ДЕЦАТА ВО ПАЗАРОТ НА ТРУДОТ – СЛУЧАЈОТ НА
КОСОВО**

**CAUSES AND CONSEQUENCES OF THE INVOLVEMENT OF
CHILDREN IN THE LABOR MARKET - THE CASE OF KOSOVO**

Abstract

The phenomenon of involvement of child on the labor market, today is known worldwide. Poverty, barriers to education and tolerant attitude towards child labor, has forced many children to work at an early age. Statistical data are scarce, but child labor is widespread in Kosovo, which represents a very disturbing fact for the country. Today in Kosovo we have a large number of children engaged in various kinds of work, and that in reality it constitutes a high risk for their age and health. The labour of children is its work, the nature of the work or how developed, harms, abuses and exploits the child, denying the right to education. Numerous studies have shown that the apparent reason for the inclusion of child in labor is poverty. If the family lives in conditions of extreme poverty, parents see children as part of the contribution to the family income.

This paper aims to identify and analyze the causes and consequences of the involvement of these children at work and gives a special contribution to the description of this phenomenon in those areas of Kosovo where it is widespread. The paper is based on quantitative data issued from a survey conducted through questionnaires and where the

¹Accounting and Finance, 'University 'HAXHI ZEKA'', Pejë, d.morina@live.com

subject of research was precisely those children who belong to different age groups and genders. End results show us that the majority of children are involved in work due to poor economic conditions and social conditions in which they are found.

Keywords: child labor, extreme poverty, health of children, disruption of schooling.

Abstrakt

Fenomeni i përfshirjes së fëmijëve në punë, sot është i njohur në të gjithë botën. Varfëria, barrierat në arsim si dhe qëndrimi tolerant ndaj punës së fëmijëve, detyrojnë shumë fëmijë të përfshihen në punë që në moshë të hershme. Të dhënat statistikore janë të pakta, por puna e fëmijëve është mjaft e përhapur edhe në Kosovë, çka paraqet një fakt mjaft shqetësues për vendin. Sot në Kosovë kemi një numër të madh të fëmijëve të angazhuar në lloje të ndryshme të punëve dhe që në realitet përbenë një rrezik të lartë për moshën dhe shëndetin e tyre. Puna e këtyre fëmijëve është punë e cila me natyrën ose mënyrën se si zhvillohet, dëmton, abuzon dhe shfrytëzon fëmijën, duke i mohuar të drejtën në arsim. Studimet e shumta kanë treguar, se arsyeja me e dukshme e përfshirjes së fëmijëve në punë është varfëria. Nëse familja jeton në kushte të varfërisë së skajshme, prindërit e shohin fëmijën si pjesë të kontributit në të ardhurat familjare.

Punimi synon të identifikojë dhe të analizojë shkaqet dhe pasojat e përfshirjes së fëmijëve në punë dhe të jep një kontribut të veçantë në përshkrimin e kësaj dukurie në ato zona të Kosovës ku është me shumë e përhapur. Punimi mbështetet në të dhëna kuantitative të nxjerra nga një hulumtim i bërë me anë të pyetësorëve, ku objekt i hulumtimit kanë qenë pikërisht këta fëmijë të cilët i përkasin moshave dhe gjinive të ndryshme. Rezultatet në fund na tregojnë se, numri më i madh i fëmijëve janë të përfshirë në punë për shkak të kushteve të rënda ekonomike dhe sociale në të cilat ata gjenden.

Fjalët kyçe: *puna e fëmijëve, varfëria e skajshme, shëndeti i fëmijës, ndërprerja e shkollimit.*

1. Hyrje

Varfëria, barrierat në arsim si dhe qëndrimi tolerant ndaj punës së fëmijëve ka bërë që sot shumë fëmijë të jenë të përfshirë në punë të ndryshme që në moshë të hershme. Puna e fëmijëve mund të përkufizohet si punë që dëmton mirëqenien e fëmijës dhe pengon edukimin,

zhvillimin dhe jetën e tij/saj të ardhshme. Puna e fëmijëve është punë e cila me natyrën ose mënyrën sesi zhvillohet, dëmton, abuzon dhe shfrytëzon fëmijën dhe i mohon fëmijës të drejtën për arsim. Aspektet kryesore që mund të dëmtojnë fëmijën përfshijnë: a) orët e gjata në punë, b) ngacmimet fizike, morale dhe psikologjike që i shkaktohen fëmijës, c) pamundësia për të ndjekur shkollën dhe për të gëzuar të drejtën për rekreacion. Në të kundërt, puna e lejuar për fëmijët përdoret për të përshkruar pjesëmarrjen e fëmijës në aktivitete ekonomike jo të dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës, dhe veçanërisht që nuk e pengojnë fëmijën që të ndjekë shkollën dhe të luajë.

Sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, shtetet si mbar-tës kryesor janë përgjegjës për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve në territoret e tyre.

Puna e fëmijëve në Kosovë ka shkaqe të shumëfishta dhe është e lidhur ngushtë me gjendjen ekonomike, me varfërinë, me mbrojtjen sociale, me funksionimin e tregut të punës, rritjen e popullsisë dhe lëvizjet migruese, faktorët kulturorë apo qëndrimet personale. Puna e fëmijëve është gjithashtu një pengesë për zhvillimin njerëzor në Kosovë dhe si e tillë nuk mund të trajtohet e izoluar nga konteksti i gjerë në të cilin ndodhë. Ka shumë arsye që i nxisin fëmijët drejt punës, sidoqoftë faktori më i rëndësishëm mbetet varfëria. Familjet e varfra i shtojnë fëmijët të punojnë në mënyrë që të shtojnë të ardhurat e tyre të pamjaftueshme. Varfëria është njëkohësisht edhe shkak edhe pasojë e punës së fëmijëve. Mirëpo, përveç varfërisë ka shumë faktorë të tjerë që kontribuojnë në punën e fëmijëve si: qëndrimi përkrahës ndaj punës së fëmijëve nga prindërit, mjedis jo i favorshëm familjar, mungesa e qasjes në arsim, diskriminimi, përhapja e sektorit joformal dhe mungesa e zbatimit të ligjit. Meqë në familjet e varfra të ardhurat përdoren vetëm për ushqim, është e qartë se të ardhurat e këtyre fëmijëve përdoren vetëm për të mbijetuar.

Ky punim ka qëllim të studioj zakonet dhe aktivitet e punës tek fëmijët e moshave të reja dhe identifikon llojin e punëve që kryejnë fëmijët në Kosovë, kushtet e punës për këta fëmijë, lidhjen ndërmjet punës së tyre dhe shkollimit dhe lidhjen ndërmjet punës së tyre dhe gjendjes ekonomiko-financiare në të cilën ndodhen ata. Punimi gjithashtu synon të analizojë shkaqet dhe pasojat e punës së këtyre fëmijëve.

2. Rishikimi i literaturës

Fenomeni i jetesës dhe i punës së fëmijëve në rrugë është i përhapur në mbarë botën, megjithatë mungojnë të dhëna të sakta lidhur me numrin e këtyre fëmijëve. Puna e fëmijëve dëmton mirëqenien e tyre, sigurinë dhe shëndetin, si dhe pengon arsimimin, zhvillimin dhe jetesën e tyre në të ardhmen. Në përcaktimin e shkaqeve themelore të punës së fëmijëve, shumica e ekonomistëve konsiderojnë se kjo është rezultat i varfërisë. Duke supozuar se të rriturit punojnë me kohë të plotë, fëmijët janë të detyruar të punojnë atëherë kur të ardhurat në familje bien dhe ulet niveli i jetesës (Basu & Tzannatos, 2003)². Prandaj ka ende një besim se rritja e të ardhurave dhe ulja e nivelit të varfërisë është hallka kryesore dhe me e rëndësishme në uljen e fenomenit të punës së fëmijëve. Në shumë vende të botës fëmijët janë të përfshirë në punë të ndryshme dhe të rrezikshme për shëndetin, duke u ndërlidhur nga kjo mungojnë të dhëna sa i përket numrit të këtyre fëmijëve. Dukuria e përfshirjes së fëmijëve në punë dhe mungesa e statistikave kombëtare nuk është karakteristikë vetëm në Kosovë. Të dhënat më të reja të nxjerra në raportet e ILO – së (International Labour Office), tregojnë se 168 milionë fëmijë në mbarë botën janë të përfshirë në punë, që përbën gati 11% të totalit të fëmijëve në botë.³ Fëmijët e përfshirë në punë të rrezikshme, që drejtpërdrejt rrezikojnë shëndetin e tyre, sigurinë dhe zhvillimin moral, përbën më shumë se gjysmën e fëmijëve që punojnë, rreth 85 milionë. Numri me i madh i këtyre fëmijëve gjendet në Azi, që paraqet rajonin me incidencën me të lartë të punës së fëmijëve në botë (një në pesë fëmijë është i përfshirë në punë).

Tabela 1. Përfshirja e fëmijëve në punë, grupmosha 7 – 17 vjet (2000 – 2012)

		Fëmijët në punësim		Puna e fëmijëve		Puna e rrezikshme	
		('000)	%	('000)	%	('000)	%
Bota	2000	351,900	23.0	245,500	16.0	170,500	11.1
	2004	322,729	20.6	222,294	14.2	128,381	8.2
	2008	305,669	19.3	215,209	13.6	115,314	7.3
	2012	264,427	16.7	167,956	10.6	85,344	5.4

Burimi: ILO (International Labour Office, 2012)

² Koltjeski, Elizabeth, (2014), Essays on the causes and consequences of child labor, *Doctoral Dissertations, University of Connecticut, f.3.*

³ International Labour Office, Marking progress against child labour, Global estimates trends 2000 – 2002 (48 pages).

Të dhënat në tabelë, na tregojnë se në periudhën e fundit katër vjeçare (2008 – 2012) ka pasur rënie të punës së fëmijëve. Numri i përgjithshëm i fëmijëve që punojnë është ulur me 47 milionë, nga 215 në 168 milionë, ndërsa numri i fëmijëve të përfshirë në punë të rrezikshme ka rënë me 30 milionë, nga 115 milionë në 85 milionë gjatë kësaj periudhe.

Autorët e huaj, si shkaktar për punën e fëmijëve i konsiderojnë faktorët socio – ekonomik, si:

Varfëria e skajshme. Studimet kanë treguar se arsyeja me e dukshme për punën e fëmijëve është varfëria (Bhat & Rather, 2009). Vendimet për punën e fëmijëve dhe për shkollimin e tyre janë përgjegjësi nga prindërit. Nëse familja jeton në kushte të varfërisë së skajshme, prindërit e shohin fëmijën si pjesë të kontributit në të ardhurat e tyre. Basu (1998) përdori një model teorik të punës së fëmijëve, ku ai tregoi se, prindërit i dërgojnë fëmijët e tyre të punojnë për shkak të ardhurave të ulëta familjare.

Madhësia e familjes. Në të vërtetë familjet e mëdha të varfra kanë më shumë fëmijë të përfshirë në punë sesa familjet me të vogla, çka tregon se madhësia e familjes ka ndikim në punën e tyre. Prindërit i detyrojnë fëmijët të punojnë për shkak se ata nuk janë në gjendje për të menaxhuar kërkesat e një familje të madhe.

Kushtet e familjes. Një numër i madh i fëmijëve që kanë humbur njërin ose të dy prindërit, janë të detyruar të punojnë në mënyrë që të mbështesin vetën dhe vëllezërit e motrat e tyre. Numri i fëmijëve jetim është në rritje, veçanërisht në Sahare, shumë prej të cilëve bëhen fëmijë të rrugës dhe jetojnë në rrethana shumë të ndryshme (Vandenberg, 2007).

Faktorët kulturorë dhe tradicional. Kultura është një tjetër faktor i cili përfshinë fëmijët në tregun e punës. Kultura të ndryshme në shoqëri të ndryshme, i shtojnë fëmijët të punojnë në moshë shumë të re. Ata supozojnë se fëmijët duhet të mësojnë dhe të jenë të aftë të jenë me të mirë për të ardhmen e tyre. Sipas Tauson (2009), në Guatemalë, prindërit preferojnë që fëmijët e tyre të punojnë, sepse konsiderojnë se ata duhet të mësojnë aftësinë e punës.

Migrimi në zonat urbane. Si pasojë e migrimit në zonat urbane, fëmijët detyrohen të punojnë në rrugë, sepse ata nuk kanë qasje në kërkesat themelore, si ushqim, strehim, dhe këta fëmijë bëhen punëtorë të rrugës. Zakonisht punëtorët e rrugës janë të pambrojtur ndaj dhunës

dhe bëhen me të ndjeshëm ndaj veprave të paligjshme, si vjedhjes, trafikimit, drogës, etj. (Yadav & Sengupta, 2009).

Ligji i punës e përcakton moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare si moshë minimale për punësim. Marrëdhënia e punës me një person ndërmjet moshës pesëmbëdhjetë (15) dhe tetëmbëdhjetë vjeçare (18) mund të vendoset për punë të lehta të cilat nuk paraqesin rrezik për shëndetin dhe zhvillimin e tij.⁴ Konventa e përkufizon punën e lehtë për këta fëmijë si punë që:

- Nuk ka gjasa të jetë e dëmshme për shëndetin ose zhvillimin e tyre, dhe
- Nuk paragjykon vijimin e tyre në shkollë, pjesëmarrjen e tyre në programet e orientimit profesional dhe trajnimit të miratuara nga autoriteti kompetent, ose nuk ndikon në kapacitetin e tyre për të përfituar nga mësimxënia.⁵

Në disa shtete, legjislacioni kombëtar ndalon punën e fëmijëve jashtë shtëpisë ose jashtë biznesit familjar. Sidoqoftë, zakonisht ligji nuk përcakton asgjë lidhur me fëmijët që punojnë brenda shtëpisë ose biznesit familjar. Supozimi mbështetës është se në raste të tilla prindërit ushtrojnë mbikëqyrjen e domosdoshme dhe ndalimi do të ishte i pazbatueshëm. Disa shtete nuk e rregullojnë punën e fëmijëve në sektorin e bujqësisë. Në atë kuptim puna e kryer nga fëmijët në këtë mjedis zakonisht bie në kategorinë e punës legale për fëmijët. Puna e rrezikshme nuk mund të jetë e pranueshme për fëmijët për shkak të zhvillimit të tyre biologjik. Kjo punë e rrezikshme ndikon negativisht në zhvillimin fizik dhe mental të fëmijës në të ardhmen. Ky është argumenti kryesor kundër punës së rrezikshme të fëmijëve. Sektori me i shpeshtë ku punojnë fëmijët është bujqësia. Sektori i bujqësisë konsiderohet si sektori ku punohen punë me të lehta për këta fëmijë, mirëpo sipas një studimi me të ri rreth 84 fëmijë vdesin në vit në mbarë botën si pasojë e aksidenteve që ndodhin në ferma dhe rreth 25.570 plagosen. Dhe mendohet se lëndimet në ferma janë shumë me serioze se në vende të tjera, për arsye se mjedisi në ferma është me i rrezikshëm për shkak se ka shumë makineri përreth, shumë kafshë të cilat e bëjnë mjedisin shumë me të rrezikshëm për fëmijët. Tetëmbëdhjetë (18) vjet duhet të jetë moshë minimale për punësim në punët të cilat për nga natyra ose

⁴ International Labour Organization, Hapat e ILO – IPEC për eliminimin e formave më të rënda të punës së fëmijëve në Kosovë, Prishtinë, 2011, f.5.

⁵ International Labour Organization, Punëdhënesit dhe puna e fëmijëve, Prishtinë, 2009, f.6.

rrethanat në të cilat kryhen mund të dëmtojnë shëndetin, sigurinë ose moralin e personit të ri. Personi nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare mund të punësohet vetëm në punë të lehta, që nuk kanë potencial për të qenë të dëmshme për zhvillimin dhe për shëndetin e tij. Në Ligjin e punës të miratuar në Kuvendin e Kosovës, në nenin 7 të tij, theksohet se marrëdhënia e punës mund të themelohet me çdo person mbi moshën tetëmbëdhjetë vjeçare.

Autori Tomas Hipson (1987) në një libër të tij mbi punën e fëmijëve, përqendrohet pikërisht në mekanizmat e mbrojtjes dhe respektimit të vlerave sociale. Ai sugjeron disa mekanizma mbrojtës që shërbejnë për vendosjen dhe respektimin e vlerave të pabarazisë sociale, sikurse është çështja e ofrimit të shërbimeve ndaj fëmijëve, po ashtu edhe ndaj atyre prindërve që nuk kanë të ardhura mujore, për shkak të gjendjes së vështirë ekonomiko-sociale. Njohësit e çështjeve sociale (Burt, Ronald, Anksel 2000) theksuan se pagat që marrin fëmijët nga puna e tyre që kryejnë shpeshherë janë nën normën minimale me standardin minimal për të jetuar. Pra me pak fjalë duhet pranuar se varfërimi i disa njerëzve, sidomos i atyre familjeve që jetojnë me 1.20 cent në ditë nuk është përmirësuar nga rritja ekonomike e vendeve ku ata jetojnë, por në disa raste është mjaft delikate dhe e vështirë për të menduar mënyrën e tyre të jetesës. (Banka Botërore 2010). Puna e fëmijëve është një specifikë mjaft komplekse dhe kërkon nevojën e trajtimit në thellësi të këtij fenomeni, pasi që kemi një numër të madh fëmijësh në punë apo që janë në fazën e hyrjes në punë. Gjatë dekadave të fundit, komuniteti ndërkombëtar ka krijuar standarde të rëndësishme se si kjo dukuri të përcaktohet dhe të eliminohet.

3. Pamje e përgjithshme mbi punën e fëmijëve në Kosovë

Studimet e fundit të kryera nga UNICEF-i në Kosovë tregojnë qartë se fëmijët janë në rrezik dukshëm të lartë të varfërisë në Kosovë në krahasim me popullsinë në përgjithësi. Në bazë të të dhënave nga ABEF 2006/7, duke shfrytëzuar kufirin e varfërisë absolute të bazuar në konsum prej 1.417€ në ditë, dhe kufirin e varfërisë ekstreme/ushqimit prej 0.934€ në ditë si dhe një normë krahasuese ndërkombëtare prej 2.15 dollarë amerikan për ditë, fëmijët e moshës 0-19 vjeç janë në rrezik më të lartë të varfërisë sesa popullsia e përgjithshme në Kosovë. Me rrezikun me të lartë të varfërisë përballën fëmijët që jetojnë në ekonomitë familjare me tre ose me shumë fëmijë, fëmijët e moshës 0-14 vjeç, fëmijët e prindërve të papunë, fëmijët në ekonomitë familjare

që marrin ndihmë sociale dhe fëmijët në ekonomitë familjare me nivel të ulët të arsimimit.⁶Kosova konsiderohet të ketë shkallën me të lartë të varfërisë në rajon. Indeksi i Zhvillimit Njerëzor e radhitë Kosovën në mesin e vendeve me zhvillim të mesëm dhe me shkallë me të ulët sesa shtetet e rajonit të Evropës Juglindore. Kosova nuk ka skemë të beneficionit për të papunët, nuk ka shtesa të amësisë dhe nuk ka skemë të beneficionit për fëmijët. Situata e rënd ekonomike pastaj përbën një shtytje për fëmijët që të punojnë. Mirëpo nuk është vetëm situata ekonomike ajo që shtynë fëmijët të punojnë. Realiteti është edhe ndryshe. Ekzistojnë edhe faktorë të tjerë përveç varfërisë që kontribuojnë në punën e fëmijëve e të cilat janë:⁷

1. *Qëndrimi përkrahës ndaj punës së fëmijëve.* Prindërit (mësuesit dhe shoqëria në përgjithësi) mund ta shohin punën e fëmijëve si pjesë e edukimit të tyre, veçanërisht kur arsimimi ekzistues nuk ofron përfitime ekonomike për të rinjtë. Prindërit mund ta mbështesin punën e fëmijëve si një mënyrë për t'i mbajtur fëmijët të sigurt, në disa zona ku fëmijët mund të diskriminohen apo të jenë subjekt i dhunës në shkolla.

2. *Mjedis jo i favorshëm familjar*— familjet me një prind, me kryefamiljar të sëmurë apo të paaftë fizikisht, varësia nga alkooli apo droga e prindërve, paaftësia prindërore, abuzimi e vendosin fëmijën në rrezik të madh për t'u përfshirë në punën e fëmijëve.

3. *Mungesa e qasjes në arsim*— kostot e drejtpërdrejta dhe indirekte të edukimit (përfshirë këtu uniformat shkollore, librat dhe pajisjet shkollore, si dhe udhëtimin për në shkollë) janë shumë të larta për prindërit që të mundësojnë ndjekjen e shkollës nga fëmijët dhe/ose shkollat janë në një distancë shumë të madhe.

4. *Diskriminimi*— minoritete apo komunitete të caktuara kanë më pak qasje në arsim apo në tregun e punës, prandaj edhe kjo shton mundësinë që këta fëmijë të kryen detyra të caktuara që në moshë të re. Për më tepër, ndarja e punës në bazë gjinore mund t'i detyrojë meshkujt dhe femrat që të kufizojnë perspektivat e tyre të punës deri në një shkallë të caktuar që nuk kërkon arsimim, por “praktikë pune” që nga moshat e reja.

5. *Përhapja e sektorit joformal dhe mungesa e zbatimit të ligjit*— Mungesa e kontratave të punës dhe e së drejtës së krijimit të asociacioneve/negotiatave kolektive në sektorin joformal e bën më të vështirë

⁶ UNICEF, Varfëria e fëmijëve në Kosovë (Raport përmbledhës), Maj, 2012, f. 7.

⁷ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Strategjia dhe plani i veprimit për eliminimin e punës së fëmijëve në Kosovë 2011 – 2016, Qershor, 2010, f. 17.

mbrojtjen e fëmijëve nga kushtet abuzive të punës, si dhe vetë identifikimin e fëmijëve që punojnë.

6. *Shkalla e lartë e migrimit*– ka kontribuar shumë në rritjen e të ardhurave në shkallë vendi. Por gjithashtu migrimi ka luajtur një rol në dobësimin e mbështetjes sociale për fëmijë, sepse shërbimet shtetërore në zonat periferike nuk kanë qenë në gjendje të përballojnë fluksin e emigrantëve nga zonat rurale.

7. *Moszbatimi i parimit të sundimit të ligjit* – ka lejuar ekonominë në hije të lulëzojë dhe korrupsionin që të pushtojë shumë aspekte të jetës së njerëzve. Kjo gjë ka ndikim të drejtpërdrejtë në a) rastet e formave të këqija të punës së fëmijëve që kanë lidhje me aktivitetet kriminale (aktivitete të jashtëligjshme, trafikim dhe prostitucion – kur një gjë e tillë është kriminalizuar), dhe b) në zbatimin e ligjeve dhe politikave të ndërlidhura me punën e fëmijëve.

4. Pasojat e punës së fëmijëve

Varfëria krijon probleme të tilla si puna e fëmijëve, korrupsioni, rritja e papunësisë, kushtet e këqija të jetesës, kequshqyerja, etj. Varfëria e fëmijëve u referohet fëmijëve të cilët kanë lindur nga prindër të varfër.⁸ Organizatat ndërkombëtare kanë bërë përpjekje të mëdha për të eliminuar punën e fëmijëve në të gjithë botën. Shumë vende kanë miratuar legjislacionin për të ndaluar punën e fëmijëve, megjithatë puna e fëmijëve vazhdon të jetë e përhapur në mbarë botën. Kjo nuk është detyrë e lehtë për vendet me të ardhura të ulëta, për të arritur ndalimin e punës së fëmijëve. Puna e fëmijëve i referohet fëmijëve të cilët humbasin fëmijërinë e tyre dhe nuk i gëzojnë privilegjet themelore që një fëmijë duhet t'i ketë. Këta fëmijë janë të keqtrajtuar dhe shpesh punojnë me orë të zgjatura dhe në kushte shumë të këqija. Kjo mund të ndikojë në shëndetin e tyre fizik, mental dhe emocional. Këta fëmijë nuk i gëzojnë të drejtat themelore si qasjen në shkollë apo në kujdesin shëndetësor. Pasojat që mund të prekin fëmijët në pikëpamjen e shëndetit dhe sigurisë janë:⁹

- Plagosjet apo gjymtimet fizike që shkaktohen nga makineritë që nuk janë mirëmbajtur mirë apo aksidentet me thika (machete) në plantacione

⁸ Osment, Leana, 2014, Child labour; the effecton child, causes and remedies to the revolving menace, Lunds Universitet, f. 15.

⁹ Fondacioni ECLT, 2005, <http://www.eclt.org/about/overview.html>.

- Helmimi nga pesticidet.
- Mungesa e rritjes është e dukshme tek fëmijët që punojnë, të cilët janë më të shkurtër dhe më të dobët sesa fëmijët tjerë; këto mangësi ndikojnë edhe në jetën e tyre më vonë kur këta të jenë në moshë të rritur.
- Problemet afatgjata shëndetësore, si sëmundjet respiratore, apo lloje të ndryshme të kancerit janë të zakonshme në vendet ku fëmijët detyrohen të punojnë me kimikate të rrezikshme.
- HIV/AIDS-i apo sëmundjet tjera ngjitëse seksuale janë të përhapura në mes të fëmijëve që detyrohen të trafikohen çdo vit.
- Stërlodhja dhe mungesa e ushqimit të duhur shfaqen si rezultat i angazhimit të fëmijëve në punë të rënda fizike, në punë me orë të gjata në kushte të papërbalueshme, pa arritur të fitojnë sasinë e duhur që të ushqejnë veten e tyre.

Puna mund të ketë dhe ndikim negativ në zhvillimin mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror të fëmijës për shkak të:

- Pamundësisë për të ndjekur shkollën normalisht. Për shkak se nuk i ndjekin mësimet apo për shkak se janë tepër të lodhur për t'u përqendruar tek lëndët mësimore, fëmijët që punojnë nuk ndjekin një arsimim normal.
- Prishjes së rrjeteve sociale (fëmijët që punojnë nuk kanë kohë të takohen me shokët e tyre) për sa kohë që mungesa në shkollë i pengon fëmijët që punojnë të shoqërohen me bashkëmoshatarët e tyre dhe të luajnë me ta.
- Aktiviteteve jo-stimuluese dhe monotone që kanë një ndikim negativ në kreativitetin/fleksibilitetin e ardhshëm të fëmijëve. Tregtia/shitja apo aktivitetet e tjera që mësojnë të bëjnë fëmijët që punojnë janë specifike dhe kërkojnë aftësi të ulëta. Kjo gjë i pengon fëmijët që të fitojnë fleksibilitetin e duhur dhe aftësitë e nevojshme për të përfituar nga mundësitë në moshën e rritur.

- Të gjitha format e keqtrajtimit, përfshirë neglizhencën, trajtimin jo të duhur dhe të rëndë, dhunën emocionale dhe shtrëngimin.

Shumë vende kanë miratuar ligje të ndryshme dhe kanë marrë iniciativa serioze për të zhdukur punën e fëmijëve, por ende problemi është shumë i përhapur në gjithë botën dhe në këtë rast në studimin tonë edhe në Kosovë. Qasjet gjithëpërfshirëse për të luftuar punën e fëmijëve kanë të bëjnë me:

- *Zhvillimin ekonomik* për të rritur të ardhurat e familjeve dhe standardin jetësor: duke mbështetur rritjen dhe shpërndarjen e burimeve

në makro nivel, si dhe duke mbështetur përpjekjet e familjeve nevojtare për të krijuar të ardhura në mikro-nivel;

- *Arsiminkualitativ*, gjithëpërfshirës, pa pagesë dhe i detyrueshëm për të shtuar kapitalin njerëzor. Përfitimi personal i arsimimit përfshin a) rritjen e shanseve për të gjetur një punësim me rrogë dhe/ose rritje në rrogë, b) lëvizshmëri më të madhe ekonomike e sociale për të shpëtuar nga kurthi i varfërisë. Përfitimet shoqërore përfshijnë planifikim familjar, pjesëmarrje më efektive politike, shtrirje të nivelit të njohurive (në përmirësimin e kujdesit shëndetësor personal e të familjes, mirëqenies e të drejtave të njeriut), një forcë pune më të aftësuar dhe kualifikuar që mund të shpie drejt një ekonomie më konkurruese;

- *Zbatimin e ligjeve kundër punës së fëmijëve*, ligjeve për arsimin e detyrueshëm, si dhe të ligjeve që në mënyrë indirekte synojnë fëmijët në konflikt me ligjin (me ndjekje penale dhe ndëshkim efektiv të kriminelëve);

- *Ndryshimin në qëndrimin e qytetarëve ndaj fëmijëve*; dhe më saktësisht, ndryshim pozitiv të qëndrimit të fëmijëve, familjeve, punëdhënësve, klientëve dhe institucioneve ndaj eliminimit të punës së fëmijëve;

- *Shërbime sociale dhe mbështetje me të holla*— për të ndihmuar familjet të mbijetojnë krizat si sëmundjet, humbjen e shtëpisë apo strehimit, dhe për të mbështetur kërkesën për arsim.

Një aspekt thelbësor i Strategjisë për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve është sigurimi se strategjitë zhvillimore dhe kundër varfërisë janë hartuar dhe zbatohen në mënyrë të tillë që të kenë ndikim pozitiv në luftimin e punës së fëmijëve. Këto strategji përfshijnë sidomos ato që promovojnë zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural, që nxisin qasjen ndaj punës dhe punësimit të denjë. Fuqizimi i mëtejshëm i kapaciteteve të mekanizmave koordinues përfshirë dhe Komitetin Kosovar për Parandalimin dhe Eliminimin e punës së fëmijëve si një trupë koordinuese dhe këshilluese për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve në Kosovë është një parakusht bazë për një qasje të koordinuar për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara në Strategji dhe në Planin e Veprimit. Beneficionet universale për fëmijë, janë parë si masë efektive kundër varfërisë sepse ato janë të lehta për tu kërkuar dhe administruar, dhe nuk ndërlihdin stigmën me skemat me verifikim të mjeteve materiale. Përderisa në kuptim të efektivitetit ato mund t'i përshtaten në veçanti shoqërive siç është Kosova me norma të larta të

fëmijëve në varfëri dhe të fëmijëve që jetojnë pak mbi kufirin e varfërisë, ekziston ngritje-zbritje në kuptim të efektivitetit dhe kostos.

5. Metodologjia


Ky punim është me tepër një studim shpjegues dhe përshkruar për punën e të miturve apo fëmijëve në Kosovë dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat që rezultojnë nga përhapja e kësaj dukurie. Studimi është zhvilluar konkretisht në ato rajone që janë me të prekura nga papunësia dhe që kanë numrin me të madh të fëmijëve në punë, d.m.th në hulumtim nuk përfshihet i terë vendi, por vetëm disa qytete ku përhapja e kësaj dukurie është shqetësuese. Metodologjia e përdorur na mundëson arritjen me sukses të objektivit tonë dhe na ndihmon të arrijmë përfundimet adekuat lidhur me atë se sa është e përhapur kjo dukuri e punës së fëmijëve në Kosovë, cilat janë punët me të shpeshta ku përfshihen fëmijët dhe cilat janë arsyet që i shtojnë këta fëmijë të braktisin shkollën dhe të inkuadrohen në punë, shumë shpesh të rrezikshme për shëndetin e tyre. Të dhënat e përfshira në punim janë të dhëna primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë mbledhur nga një hulumtim i bërë me 100 fëmijë të kësaj kategorie të cilët punojnë punë të ndryshme në rajone të ndryshme të vendit. Këto të dhëna janë kryesisht kuantitative të realizuara përmes një pyetësi i cili ka përmbajtur vetëm pyetje të mbyllura, e të cilat pyetje kanë qenë të dizajnuara në atë mënyrë që të mundësojnë arritjen e qëllimit tonë në këtë punim. Zgjedhja e mostrës për anketim ka qenë e vullnetshme, d.m.th në anketim kanë marrë pjesë vetëm ata fëmijë që kanë dëshiruar të jenë pjesë e hulumtimit. Mostra gjithashtu ka qenë e stratifikuar edhe në aspektin e moshës së këtyre fëmijëve, dhe ka përfshirë fëmijë të të gjitha moshave.

Ndërsa të dhënat sekondare e përbëjnë pjesën teorike të studimit, e të cilat të dhëna janë marrë nga literatura të ndryshme. Punimet akademike si kërkimet shkencore, punime konferencash apo edhe leksione dhe raporte të ndryshme mbi punën e fëmijëve kanë plotësuar kuadrin e burimeve sekondare. Të dy tipat e informacionit, si primar ashtu edhe ai sekondar kanë ndihmuar metodologjinë e përdorur për të parë cilat janë pasojat e përhapjes së kësaj dukurie dhe cilat janë masat që duhet të merren për eliminimin e saj.

6. Analizë empirike lidhur me përfshirjen e fëmijëve në tregun e punës në Kosovë


Në këtë studim është bërë përpjekje për të analizuar situatën, shkaqet dhe pasojat e punës së fëmijëve në Kosovë. Është bërë gjithashtu përpjekje për të ndërgjegjësuar në radhë të parë fëmijët, por edhe prindërit e tyre për pasojat që sjellin punët e rënda për shëndetin dhe zhvillimin e tyre në të ardhmen. Gjatë realizimit të hulumtimit, kemi vërejtur se kjo dukuri është shumë përhapur në vendin tonë, shkaqet dhe pasojat e së cilës shihen në vazhdim.

Figura 1. Moshat aktuale e fëmijëve të anketuar të përfshirë në punë (mostra)



Për studim janë përzgjedhur fëmijët që nga moshën e lejuar (nën 10 vjeç) e deri në moshën 17 vjeçare. Moshën tetëmbëdhjetë vjeçare nuk është përfshirë në anketim, sepse ata nuk konsiderohen me fëmijë. Sipas grafikut 1, grupmosha më e hasur e fëmijëve në punë, është ajo mbi 15 vjet, d.m.th prej 15 deri në 18 vjeç, me rreth 60%. E ndjekur nga grupmosha mbi 10 vjet, me 28%, kurse grupmosha nën 10 vjet, me 12%. Shihet se barrën kryesore për kujdesin ndaj familjes në rastet e varfërisë së skajshme e mbajnë fëmijët mbi 15 vjet. Është parë gjithashtu nga studimi se pjesa më e madhe e këtyre fëmijëve kanë filluar punën në moshën 11 vjeçare. Ata janë detyruar që në atë kohë të braktisin shkollimin për të filluar një jetë krejtësisht ndryshe nga moshatarët e vet.

Figura 2. Vijueshmëria e fëmijëve të anketuar në shkollë (mostra)




Është parë se më përfundimin e shkollimit fillor, shumica prej këtyre fëmijëve braktisin shkollimin dhe nuk e vijojnë shkollën e mesme. Klasa me e lartë e përfunduar nga fëmijët që punojnë është klasa e nëntë. Nga rezultatet tona shihet se rreth 54% e këtyre fëmijëve vijojnë ende mësimin, 30 % prej tyre kanë ndërprerë tërësisht vijimin në shkollë dhe një pjesë prej 16% nuk e vijojnë rregullisht mësimin, mirëpo vetëm atëherë kur kanë kohë. Gjithashtu kemi parë se rasti i braktisjes së shkollës nga djemtë është me i lartë se tek rasti i vajzave. Analiza na ka treguar se shkak i mungesës së fëmijëve në shkollë vjen drejtpërdrejt nga përfshirja e tyre në punë. Ka pasur edhe fëmijë të përfshirë në anketim të cilët kanë deklaruar se arsyeja e punës së tyre është se kanë dëshirë të kenë të holla personale dhe të jenë të pavarur nga prindërit, mirëpo kjo përqindje është shumë e vogël krahasuar me ata fëmijë të cilët janë të detyruar të punojnë si shkak i varfërisë ekstreme në të cilën jetojnë. Varfëria dhe puna e fëmijëve janë komponentët kryesorë të “ekuilibrit të ulët ekonomik” në nivel të familjes, komunitetit dhe vendit. Për këtë arsye, puna e fëmijëve është një pikë themelore për ndërhyrje në masat që merren për zbutjen e varfërisë dhe mbrojtjen sociale, edhe në mes të familjeve shumë të varfra, për të cilat është vështirë të gjenden zgjidhje të qëndrueshme (përveç asistencës direkte sociale).

Në Kosovë, të varfrit jetojnë në kushte të banimit që janë jashtë normave të standardit jetësor. Punësimi është faktori kryesor që shtrinë efektet e veta për jetë me të mirë, për ngritjen e standardit të banimit, në mirëmbajtjen e shëndetit, etj. Fëmijët janë të detyruar të punojnë në rastet varfërisë së skajshme, për faktin se janë ata që duhet të sjellin të ardhura në familje, edhe në rastet kur jetojnë me të dy prindërit, siç

CENTRUM 5

shihet nga rezultatet. Rreth 50% e fëmijëve që punojnë kanë deklaruar se jetojnë me të dy prindërit, mirëpo janë të detyruar të punojnë për shkak të kushteve të vështira të jetesës. Pjesë e madhe, rreth 32% jetojnë vetëm me nënën dhe janë të detyruar të luajnë rolin e kryefamiljarit dhe mbajtësit kryesorë të familjes. Një pjesë tjetër prej, prej 5% jetojnë vetëm me babain, ndërsa rreth 4% e tyre nuk jetojnë me asnjërin prind.

Figura 3. Jetesa brenda familjes së fëmijëve të përfshirë në punë (mostra)



Sa i përket vijimit të këtyre fëmijëve në shkollë, kemi parë se vijueshmëri me të lartë në shkollë kanë ata fëmijë të cilët jetojnë me të dy prindërit, rreth 54 %, pra të gjithë fëmijët të cilët jetojnë me të dy prindërit shkojnë në shkollë pavarësisht punës që bëjnë. Ndërsa ata të cilët nuk shkojnë fare në shkollë ose që kanë mungesa në vijueshmëri, ishin ajo kategori e fëmijëve të cilët jetonin vetëm me njërin prind, në këtë rast vetëm me nënën. Prej 30% të fëmijëve që nuk shkonin në shkollë, pjesa më e madhe e tyre (20%), jetonin vetëm me nënën.


Tabela 2. Lidhja në mes të variablave 'vijueshmëria në shkollë' me 'jetesën' e fëmijëve të anketuar (mostra)

Vijueshmëria në shkollë * Jetesa Crosstabulation

Count		Jetesa				Total
		Më të dy prindërit	Vetëm me babain	Vetëm me nënën	Me asnjërin nga prindërit	
Vijueshmëria në shkollë	PO	54	0	0	0	54
	JO	5	5	20	0	30
	Kur kam kohë	0	0	12	4	16
Total		59	5	32	4	100

Sa i përket llojit të punëve që kryejnë fëmijët, nga studimi kemi venë re se fëmijët me së shumti punojnë, punë krahu, punë në bujqësi, punë në rrugë, zejтари, etj. Nga përgjigjet e të anketuarve del se, në punë krahu janë të përfshirë 41% e këtyre fëmijëve, 29% në sektorin e bujqësisë, punë në rrugë apo kërkim lëmoshe 16% e këtyre fëmijëve dhe 14% në forma të tjera të punës. Puna e fëmijëve në sektorin e bujqësisë është e përhapur me shumë në zonat rurale, ku ruajnë bagëtinë, punojnë në kopshtet dhe oborret e shtëpive, shesin produkte të qumështit, etj. Puna në rrugë është punë e shpeshtë që e kryejnë fëmijët, duke bredhur nëpër rrugë, nëpër restorante, nëpër kafene të ndryshme, madje edhe gjatë orëve të vonshme të mbrëmjes, çka paraqet një rrezik për jetën e tyre.


Figura 4. Llojet e punës që kryejnë fëmijët (mostra)



Lëmosha, është dukuri e cila çdo ditë e më shumë po bëhet shqetësuese për vendin tonë. Moshë e fëmijëve që kërkojnë lëmoshë sillet nga 8 deri në 13 vjet. Kjo formë e punës ka përmasa shqetësuese, sidomos të fëmijët e komunitetit rom. Në radhë të parë, ata rrezikojnë shëndetin e tyre, meqë këtë punë e ushtojnë në udhëkryqe, semaforë dhe në vende të tjera të rrezikshme. Puna në rrugë përfshinë edhe shitjen e mallrave të ndryshme nga fëmijët, duke përfshirë këtu shitjen e cigareve nëpër lokale të ndryshme, ku janë të përfshira grupmosha të ndryshme të fëmijëve, me theks të veçantë moshat e reja. Fëmijët këtë lloj të punës e kryejnë në tezgja të vendosura në rrugë, si dhe duke bredhur nëpër rrugë. Kemi përmendur me herët pasojat e punës së këtyre fëmijëve dhe rrezikun që puna që bëjnë sjell për jetën e tyre. Në pyetjen se ‘A keni dijeni për rrezikun që sjell puna që bëni’, fëmijët janë përgjigjur si më poshtë: nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, del

se 41% e tyre kanë dijëni për rrezikun që sjell kjo punë dhe shumë nga këta fëmijë janë të frikësuar për punën që bëjnë. Pjesa tjetër e këtyre fëmijëve, 43% nuk kanë fare dijëni për punën që bëjnë dhe për rrezikun që ju kanoset gjatë kryerjes së punës. Ndërsa në fund, rreth 16% e tyre kanë fare pak njohuri për punën që bëjnë.

Figura 5. Dijënia e fëmijëve për rrezikshmërinë e punës që bëjnë (mostra)



Nga anketimi kemi vërejtur gjithashtu se këta fëmijë asnjëherë nuk njoftohen për rrezikun që mund t'u kanoset gjatë kryerjes së këtyre punëve. Këtë e vërteton edhe mungesa e fletushkave informative për pasojat që sjellin punët e rënda dhe të rrezikshme për moshën e fëmijëve në përgjithësi. Ata asnjëherë nuk kanë marrë asnjë informata as nga prindërit, as nga shoqëria, e as nga shkolla, për pasojat që sjellin punën e rënda dhe të rrezikshme. Fëmijëve duhet të ju ofrohen shërbime sa më cilësore, që ndikojnë fuqishëm, për vetëdijesimin e tyre. Qëllimi është që ata të aftësohen, pra të kuptojnë se duhet të heqin dorë nga punët e rënda dhe të rrezikshme për shëndetin e tyre dhe të vijnë me rregull mësimin. Për këtë është e nevojshme të angazhohen institucionet edhe në nivel lokal edhe në atë qendror. Në disa shtete, legjislacioni kombëtar, ndalon punën e fëmijëve jashtë shtëpisë ose jashtë biznesit familjar. Sidoqoftë, ligji nuk përcakton asgjë në lidhje me fëmijët që punojnë brenda shtëpisë apo biznesit familjar.¹⁰ Supozimi mbështetës është se në raste të tilla prindërit ushtrojnë mbikëqyrjen e domosdoshme dhe ndalimi do të ishte i pazbatueshëm. Disa shtete nuk rregullojnë punën e fëmijëve në sektorin e bujqësisë. Në atë kuptim puna e kryer nga fëmijët në këtë mjedis zakonisht bie në kategorinë e punës legale për fëmijët.


¹⁰ International Labour Organization, Punëdhënësit dhe puna e fëmijëve, Prishtinë, 2009, f.23.

CENTRUM 5

Se a kryhet puna në mjedis të rrezikshëm apo jo, vërehet nga detyrat që kryejnë fëmijët, materialet që përdorin për këtë qëllim, numrin e orëve që punojnë etj., i mbetet prindërve që të mbrojnë fëmijët e tyre.

Të ardhurat që fëmijët realizojnë me punën që bëjnë, qoftë në rrugë, bujqësi apo në ndonjë vend tjetër, janë shumë pak të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të tyre jetësore. Ato të ardhura që ata realizojnë mjaftojnë vetëm për mbijetesë. Zakonisht në ato familje ku fëmijët punojnë, nuk ka të ardhura tjera përveç punës së tyre. Si shkak i kësaj, ato familje jetojnë në kushte tejet të rënda ekonomike. Kur janë pyetur fëmijët se ‘A marrin ndonjë ndihmë financiare nga jashtë’ nga shteti në këtë rast, 67% e tyre janë përgjigjur jo, 12% e tyre janë përgjigjur po dhe 21% e tyre kanë thënë së shumë pak marrin ndihmë nga jashtë. Tek ne mbështetja e vetme për këto familje është asistenca sociale, të cilën jo të gjitha familjet mund ta gëzojnë, dhe gjithashtu shumica e saj është shumë e pamjaftueshme për jetesë.

Figura 6. Ndhimja financiare nga jashtë



Kosova nuk ka skemë të beneficionit për të papunët, nuk ka shtesa të amësisë dhe nuk ka skemë të beneficionit për fëmijët. Ajo ka skemën e pensionit social, skemën për invalidët e luftës dhe familjet e të rënëve gjatë luftës, dhe skemën e pensionit invalidor. Përveç kësaj, Kosova ka paraqitur një skemë të re në vitin 2009 që shënjestronte familjet që kujdesen për fëmijët me paaftësi të rënda dhe të përhershme. Nga kjo skemë përfitojnë 2,158 përfitues të cilët pranojnë nga 100€ në muaj. Transferi kryesor i parave të gatshme për familjet e varfra është skema e ndihmës sociale e financuar nga buxheti i Kosovës. Janë dy kategori të ndihmës sociale: Kategoria I, mbulon ekonomitë familjare të varfra ku asnjë familjar nuk është në gjendje që të punojë ose ku i rrituri i

vetëm që është i aftë të punojë kujdeset përherë për një person të varur. Kategoria II, mbulon ekonomitë familjare të pranueshme ku familjarët e rritur janë të papunë dhe ku së paku një fëmijë është i moshës 5 vjeçare ose nën atë moshë ose është fëmijë jetim gjer në moshën 15 vjeçare.¹¹ Beneficionet për fëmijë janë transfere direkte të parave të gatshme për familjet dhe fëmijët dhe mund të jenë masë efektive kundër varfërisë dhe ndihmojnë zbutjen e kostove shtesë të ndërlidhura me numrin e fëmijëve. Së bashku me pensionin bazik social, ndihma sociale/të ardhurat minimale, dhe shërbimet themelore sociale, ato janë një element i ‘bazës së propozuar të mbrojtjes globale sociale’ që është parë si e arsyeshme dhe përgjigje efektive ndaj varfërisë (Cerami dhe Stubbs, 2010; Hujo, 2009).

7. Përfundim

Mbështetur në informacionin e mbledhur përmes anketimit, si dhe mbështetur në raportet e nxjerra mbi hulumtimin e gjendjes ekonomiko – sociale në Kosovë, ne kemi ardhur në këto përfundime:

Arsyeja kryesore e përfshirjes së fëmijëve në punë, është gjendja ekonomiko – sociale në të cilën gjenden ata. Me shumë se 65% e fëmijëve të anketuar kanë deklaruar së kushtet e rënda ekonomike i shtyjnë ata të punojnë. Pjesëmarrja e madhe e fëmijëve në punë, rrit edhe me shumë papunësinë, sepse shtohet numri i të rriturve që mbesin pa punë, si pasojë e papunësisë në nivel vendi. Grupmosha me përqindje më të lartë në punë është ajo prej 15 deri në 18 vjet. Sa i përket punëve që ata kryejnë, nga studimi kemi parë se pjesa më e madhe e këtyre fëmijëve janë të angazhuar në punë krahu, rreth 41% e tyre. Një përqindje e madhe gjithashtu, rreth 29% kryejnë punë të ndryshme në bujqësi, pastaj 16% punë në rrugë, duke përfshirë këtu edhe kërkimin e lëmoshës, dhe pjesa tjetër kryejnë punë të tjera të ndryshme. Të gjitha këto llojet të punëve që kryhen nga ana e fëmijëve, pa marrë parasysh ku kryhen, paraqesin rrezik të lartë për shëndetin dhe për jetën e tyre. Mirëpo për shkak të shkallës së ulët të vetëdijesimit të këtyre fëmijëve, shumica prej tyre, rreth 43% nuk janë në dijeni për rreziqet që ju kanozen nga puna, sidomos nga puna në rrugë. Mungesa e vetëdijes së fëmijëve, por edhe mosinteresimi i prindërve ka bërë evidente përfshirjen e fëmijëve në punë të rënda dhe të rrezikshme për shëndetin e tyre. Gjithashtu, faktorë shtytës në këtë drejtim janë edhe papunësia e

¹¹ UNICEF, Varfëria e fëmijëve në Kosovë (Raport përmbledhës), Maj, 2012, f. 8.

prindërve, mungesa e kushteve për të jetuar në një mjedis të qetë dhe të sigurt, niveli i ulët i vetëdijesimit të popullatës dhe mungesa e infrastrukturës për të ndjekur procesin e rregullt mësimor. Një tjetër faktor kontekstual është lëvizja në zonat urbane, si zona me një nivel më të lartë ekonomik. Kjo ka bërë që të shtohet fluksi i numrit të fëmijëve që kërkojnë lëmshë në rrugë të ndryshme të qyteteve. Në radhë të parë, ata rrezikojnë shëndetin e tyre, meqë këtë punë e ushtrojnë në udhëkryqe, semaforë dhe në vend të tjera të rrezikshme. Puna në rrugë përfshinë edhe shitjen e mallrave të ndryshme nga fëmijët, duke përfshirë këtu shitjen e cigareve nëpër lokale të ndryshme, ku janë të përfshira grupmosha të ndryshme të fëmijëve, me theks të veçantë moshat e reja.

Paratë që marrin këta fëmijë nga puna që bëjnë janë shumë pak, dhe nuk ju mjaftojnë as për mbijetesë, për shkak se në shumicën e rasteve, familjet e këtyre fëmijëve nuk realizojnë të ardhura të tjera, përveç punës së këtyre fëmijëve. Është e nevojshme të merren masa në mbështetje të këtyre fëmijëve, në mënyrë që të zvogëlohet kjo duhuri e përfshirjes së tyre në punë dhe këta fëmijë t'i kthehen shkollimit, pasi që kemi parë se pjesa më e madhe e fëmijëve që punojnë e kanë ndërprerë shkollimin, në pamundësi për të vazhduar tutje.

8. Conclusion

Based on information collected through a survey, and based on research reports issued on the economic situation - social situation in Kosovo, we have arrived at the following conclusions:

The main reason for the inclusion of child in labor market , is the economic- social situation in which they found. More than 65% of children surveyed have stated that severe economic conditions, have pushed them to work. Participation of children in employment, it has led to increased unemployment because increasing numbers of adults who lose their jobs as a result of countrywide unemployment. The age group with the highest percentage in work is 15 to 18 years. Regarding the work they perform, from the study we have seen that most of these children are engaged in manual labor, about 41% of them. A large percentage, around 29% perform different jobs in agriculture, then, 16% work on the streets, including begging, and the rest perform other different. All these kinds of work performed by children, irrespective of where performed represent a high risk to health and their lives. However, due to the low level of awareness of these children, most of them, about 43% they are unaware of the dangers posed to us that you work,

especially the work on the road. Lack of awareness of children, but also parents', lack of interest, made evident inclusion of children in hard labour and hazardous to their health. Also, the push factors in this regard are the unemployment of parents, lack of conditions to live in a quiet and safe, low level of awareness of population and lack of infrastructure to follow regular teaching process. Another contextual factor is the movement in urban areas, such as areas with a high level of economic development. This has led to increased flux of the number of children begging, on the streets of various cities. In the first place, they endanger their health, since this work is done at intersections, traffic lights and other dangerous places. Street work includes selling various goods from children, including the sale of cigarettes in various localities, which included different age groups of children, with emphasis on special parts of the new age.

The money that these children receive from the work they do are very few, and not even enough for survival, because in most cases, the families of these children do not realize other income except than the work of these children. It is necessary to take measures in support of these children, in order to reduce their involvement in the work and these children to be returned to school, because we have seen that among the biggest of working children have left school, because they were unable to continue.

9. References

Ahmad, Ayaz (2012) Poverty, Education and Child Labour in Aligarh City-India. Stud Home Com Sci. pp. 165-172

Basu, K. (1999) "Child Labor: Cause, Consequence, and Cure, with Remarks on International Labor Standards" Journal of Economic Literature, Vol. XXXVII

Basu, K., & Tzannatos, Z. (2003). The Global Child Labor Problem: What Do We Know and What Can We Do? *The World Bank Economic Review*, 17(2), 147-173

Bhat BA and Rather TA, (2009). Child labour in the handicrafts home industry in Kashmir: A sociological study, Int NGO J, 4 (9). 391-400

Fondacioni ECLT, 2005,
<http://www.eclt.org/about/overview.html>

International Labour Office, Marking progress against child labour, Global estimates trends 2000 – 2002 (48 pages)

International Labour Organization, Hapat e ILO – IPEC për eliminimin e formave më të rënda të punës së fëmijëve në Kosovë, Prishtinë, 2011.

International Labour Organization, Punëdhënesit dhe puna e fëmijëve, Prishtinë, 2009, fq.6

International Labour Organization, (2012). *Tackling child labour: From commitment to action* International Programme on the Elimination of Child Labour (IPEC) – Geneva: vol. 1

International Labour Organization, (2013). *World Report on Child Labour Economic vulnerability, social protection and the fight against child labour*. Geneva

International Labour Organization, Punëdhënesit dhe puna e fëmijëve, Prishtinë, 2009, fq.23.

Kolteski, Elizabeth, (2014), *Essays on the causes and consequences of child labor, Doctoral Dissertations, University of Connecticut*.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Strategjia dhe plani i veprimit për eliminimin e punës së fëmijëve në Kosovë 2011 – 2016, Qershor, 2010, fq. 17

Osment, Leana, 2014, *Child labour; the effecton child, causes and remedies to the revolving menace*, Lunds Universitet, fq, 15

UNICEF, Varfëria e fëmijëve në Kosovë (Raport përmbledhës), Maj, 2012, fq. 7

UNCIEF (2000). *Poverty reduction begins with children*

Tauson, Michaelle (2009). "Child Labour in Latin America: Poverty as Cause and Effect.

Yadav, S and Sengupta, G (2009). *Contend that children are more vulnerable than adults due to their brain of the child is not fully developed*

Yadav, S., and Sengupta, G. (2009). "Environmental and Occupational Health Problems of Child Labour: Some Issues and Challenges for Future." *J. Hum Ecol.* 28.2